

VENDIM
Nr. 73, datë 28.1.2015

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË,
NDËRMJET MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE
SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË “PRIMAVERA INDUSTRY”
SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË “SALLË PRODHIMI NË KATIN
PËRDHES NË “PRODHIM VESHJE” SHA, DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënëse, dhe shoqërisë “Primavera Industry” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Sallë prodhimi në katin përdhes në “Prodhim veshje” sh.a., Durrës”, me sipërfaqe të përgjithshme 892 (tetëqind e nëntëdhjetë e dy) m².

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama